



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

V E N D I M

Nr. 164, Datë 19/11/2015

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit Nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën Nr. 129, datë 26.12.2014, të paraqitur nga subjekti ankues z. kundër kompanisë Albpetrol sh.a Patos, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të lidhjes familjare¹. Për këtë shkak subjekti ankues pretendon se është diskriminuar dhe viktimizuar në fushën e punësimit.

Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

Sipas shpjegimeve të dhëna në ankesë z. informon se që nga data 23.07.2007 ka filluar punë pranë kompanisë Albpetrol sh.a Patos në pozicionin e juristit dhe deri më sot nuk është marrë asnjë masë disiplinore ndaj tij. Ankuesi deklaron se veprimet diskriminuese ndaj tij dhe familjes së tij kanë filluar pas denoncimeve që prindërit e tij, z. dhe z. kanë bërë në drejtim të punëdhënësit z. në cilësinë e Administratorit të kompanisë Albpetrol sh.a. Z. në ankesën e tij informon se babai i tij z. me anë të disa shkresave⁴ ka kërkuar nga Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a ndalimin e sjelljeve diskriminuese dhe presionin psikologjik për largimin e tij nga puna.

deklaron se me datë 03.09.2014 është thirrur nga z. Drejtor i Qendrës së Prodhimit Naftë Gaz dhe Rërë Patos, i cili i ka komunikuar se me urdhër në formë verbale të

¹ Është i biri i dhe të cilët kanë paraqitur ankesë për diskriminim pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

² Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi me Vendimin nr.202, datë 09.12.2014 ka konstatuar diskriminimin e drejtpërdrejtë të z. nga ana e Albpetrol sh.a, për shkak dhe të përkatësisë në grupimin sindikal.

³ Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi me Vendimin nr. 203, datë 09.12.2014 ka konstatuar diskriminimin e të zn. formën e viktimizimit nga ana e Albpetrol sh.a.

⁴ Me shkresën nr. 4428, datë 27.05.2014, subjekti ankues i drejtohet z. i kërkon që të ndërpritet diskriminimi ndaj tij nga ana e drejtuesve të Q.A.R-së lidhur me marrëdhëniet e punës mes tij dhe kësaj shoqërie. Me shkresën nr. 5626, datë 10.07.2014, z. në dijeni z. ushtrohet diskriminim i hapur dhe presion psikologjik për ta pushuar nga puna.

Administratorit, z. shte i pushuar nga puna në mënyrë të menjëhershme pa i vënë në dispozicion një urdhër me shkrim. Me kërkesën datë 16.10.2014, avokat në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të a kërkuar nga Albpetrol sh.a arsyet e mos pagesës së pagës së për periudhën Shtator-Nëntor 2014. . deklaroi se deri më sot nuk ka marrë përgjigje për kërkesën e bërë.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri, konstatimin e diskriminimit dhe rikthimin e tij në vendin e punës.

Me shkresën datë 13.01.2015 drejtuar Komisionerit, subjekti ankues deklaroi se në vitin 2008 kompania Albpetrol sh.a me anë të marrëveshjes nr. 5070/1, datë 24.09.2008 ka mbuluar shpenzimet financiare për kualifikimin profesional të tij, në një marrëveshje 2-vjeçare deri në përfundimin e studimeve master pa shkëputje nga puna.

Gjithashtu ankuesi bën me dije se që nga data 01.08.2013 ka nënshkruar një kontratë pune individuale, 2-vjeçare me punëdhënësin Albpetrol sh.a në të cilën përcaktohen dhe marrëdhëniet e ndërsjellta mes punëdhënësit dhe punëmarrësit.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *"Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër"*.

Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi" mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Bazuar në nenin 33/4 të ligjit nr. 10221/2010, "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", ankesa e paraqitur nga ankuesi, z. shtë e vlefshme nga pikëpamja formale pasi nuk ekziston asnjë nga rastet përjashtuese të parashikuara në këtë nen, që do ta bënte këtë ankesë të papranueshme. Si pasojë ankesa iu nënshtroi shqyrtimit të plotë.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", Komisioneri për mbrojtjen nga diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën Nr. 11, datë 09.01.2015 është bërë njoftimi i subjektit Albpetrol sh.a në lidhje me ankesën.
- Me shkresën nr. 42/1, datë 23.01.2015 i është kërkuar informacion subjektit Albpetrol sh.a, në lidhje me ankesën për pretendimin për diskriminim të paraqitur nga

Me shkresën Nr. 629/1, datë 18.02.2015 të dërguar pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Albpetrol sh.a informon se: “Me shkresën nr.1408, datë 29.04.2011 pranë Qendrës së Prodhimit Hidrokarbureve (sot Q.P.N) është krijuar shtesë strukture për pozicionin e punës specialist “Jurist” në të cilën është emëruar znj. () me shkresën nr.3762/1, datë 16.11.2011 është transferuar në QPH Patos në pozicionin e punës “Operator Prodhimi” dhe është paguar si punonjës me arsim të lartë. Në zbatim të shkresës nr. 3762/3, datë 18.04.2012, z. është emëruar në pozicionin e punës “Specialist jurist i lartë” ndërkohë që struktura organizative në fjalë parashikonte vetëm një vend pune për “Specialist jurist i lartë”, pozicion në të cilin ishte emëruar znj. Shoqëria Albpetrol sh.a Patos i është nënshtruar riorganizimit në periudhën Maj 2013 dhe Qendra e Hidrokarbureve Patos u emërua Qendra e Prodhimit Naftë, Gaz, Rërë Patos (QPNGR) në të cilën vazhdon të kishte në përbërje vetëm një pozicion pune jurist, të cilin e mbulonte znj. Dine). Duke qenë se znj. filloi trajtimin me leje lindje nga data 26.08.2013 vendi i punës “Jurist” vazhdoi të mbulohej nga z. deri më datë 21.07.2014. Pas rikthimit të znj. ga trajtimi me leje lindje, shoqëria Albpetrol me datë 08.08.2014 ka njoftuar z për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, mbështetur në nenin 143- 144 të Kodit të Punës”.

- Me shkresën Nr. 42/4, datë 25.02.2015, kompanisë Albpetrol sh.a, i është kërkuar, kopje të regjistrit themeltar ku pasqyrohen lëvizjet në punë të z. kopje të emërimit dhe lëvizjeve në detyrë për znj. kopje të plotë të procedurës së ndërprerjes së marrëdhënieve të punës me z opje të dokumentacionit të fillimit dhe mbarimit të lejes së lindjes të znj.E. ërime të personelit Jurist pranë Albpetrol pas datës 21.08.2014 dhe kopje të procedurës/ave të marrjes në punë si dhe kopje të strukturës organike të kompanisë Albpetrol sh.a nga viti 2011 (QPN / QPNGR Patos).

Me shkresën Nr. 629/3, datë 17.03.2015 kompania Albpetrol sh.a ka dërguar pranë Komisionerit dokumentet e mëposhtme: - Kopje të regjistrit themeltar me lëvizjet në punë të kopje të emërimit dhe lëvizjeve në detyrë dhe dokumentacionit të fillimit e mbarimit të lejes së lindjes për znj. i dhe kopje të strukturës organizative të kompanisë Albpetrol sh.a Patos.

- Me shkresën nr. 259 datë 18.03.2015 u njoftuan subjektet për realizimin e një seance dëgjimore mes palëve për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimet e tyre.

Më datë 25.03.2015 në mjediset e zyrës së Komisionerit u zhvillua seanca dëgjimore. Në këtë seancë nga ana e Albpetrol sh.a morën pjesë, znj. ne detyrë specialiste pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe z. me detyrë jurist pranë Albpetrol sh.a si dhe

z. përfaqësues me prokurë i z. . Në këtë seancë, palët parashtruan pretendimet e tyre, lidhur me çështjen objekt shqyrtimi nga Komisioneri.

Gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore znj. deklaroi se në dijeninë e saj pas datës 21.08.2014 vetëm z. është emëruar në pozicionin si jurist pranë Qendrës së Shërbimit Geofizik (QSHG), Patos. E pyetur lidhur me faktin e mos pagesës së z. për periudhën Shtator-Nëntor 2014, znj. çaroi se pagesat në fjalë nuk janë kryer për shkak se z. nuk është paraqitur në punë⁵.

Gjatë zhvillimit të seancës z. i informoi se pas largimit nga puna të djalit të tij z. kanë Albpetrol sh.a janë emëruar disa persona: Y.S, H.Gj. G.M dhe të tjerë.

- Për verifikimin e pretendimit të ngritur nga z. në datë 22.05.2015 nxirret Urdhri Nr. 83, "Për kryerjen e inspektimit pranë shoqërisë Albpetrol sha".
- Me shkresën Nr. 509/1 Prot, datë 22.05.2015 njoftohet subjekti Albpetrol sha për kryerjen e inspektimit me datë 28.05.2015.

Me datë 28.05.2015, u realizua inspektimi pranë subjektit, Albpetrol sha. Nga ana e Albpetrol ishin të pranishëm znj. dhe detyrë K/specialiste pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe znj. me detyrë specialiste pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të Albpetrol sh.a.

Gjatë inspektimit znj. deklaroi se pas datës 21.08.2014 pranë Albpetrol sha kanë filluar punë në pozicionin e juristit vetëm dy punonjës, z. dhe z. . Nga grupi i inspektimit u verifikuan dokumentacionet e emërimeve në detyrë për punonjësit⁶: A.I, A.Ç, R.M, Th.M, O.K, A.K, G.M dhe B.K. Në përfundim të verifikimit të dokumentacionit rezulton se të gjithë këto emëime janë kryer përpara datës 21.08.2014, periudhë kur është larguar nga puna . Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se: z. është emëruar në pozicionin e punës si Jurist pranë qendrës Q.A.R. Patos me Vendimin nr. 595, datë 21.10.2014, ndërsa është emëruar në pozicionin e punës Jurist pranë Q.SH.GJ. Patos me Vendimin nr. 41, datë 27.01.2015.

Pas vlerësimit të fakteve e provave të grumbulluara dhe në analizë të legjislacionit në fuqi, Komisioneri vlerëson:

Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ofron mbrojtje dhe rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh⁷. Në nenin 1, ligji liston një sërë

⁵ Vërtetuar me listë pagesat e punonjësve për periudhën Korrik – Dhjetor 2014 të depozituar gjatë seancës dëgjimore.

⁶ Sipas pretendimeve të subjektit ankues.

⁷ Neni 1, i ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi": "Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje meose me çdo shkak tjetër."

shkaqesh për të cilat garantohet mbrojtja nga diskriminimi, por mbyllet me përcaktimin se ligji merr në mbrojtje edhe shkaqe të tjera që nuk janë listuar në nenin 1.

Neni 1, i ligjit "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi" është në linjë edhe me parashikimet e nenit 14 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ-së), e cila sanksionon mbrojtjen nga diskriminimi bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh⁸.

Në mungesë të një praktike kombëtare Komisioneri i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Ky referim bëhet duke mbajtur parasysh, hierarkinë e normave juridike të sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, i cili sanksionon epërsinë e të drejtës ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë mbi ligjet e brendshme. Në referim edhe të evokimit që i bëhet Konventës në nenin 17/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ajo merr një status kushtetues në të drejtën tonë të brendshme. Për rrjedhojë edhe praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me anë të të cilës bëhet interpretimi i Konventës, ka fuqinë e Konventës.

Referuar kësaj praktike, GJEDNJ-ja ka mbajtur qëndrimin se diferencat që kanë si bazë ose për arsye një karakteristikë personale, që e bën të dallueshme një person ose grup personash nga të tjerët, janë të lidhura me nenin 14 të Konventës dhe me këtë interpretim ajo ka përcaktuar statuse të tjera që nuk janë përcaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga neni 14 i Konventës. I njëjti arsyetim mund të na shërbejë edhe në rastin e vlerësimit të shprehjes "me çdo shkak tjetër", të parashikuar në nenin 1 të ligjit "Për mbrojtjen nga diskriminimi". **Pretendimi i ankuesit se shkak për diskriminimin e tij është lidhja familjare me z. [emri] dhe znj. [emri] i që janë prindërit e tij dhe që kanë denoncuar veprimet diskriminuese të drejtuesve të shoqërisë Albpetrol sh.a, përbën një shkak që gëzon mbrojtje sipas nenit 1 të ligjit.**

Po kështu, duke iu referuar faktit që z. [emri] dhe znj. [emri] kanë paraqitur ankesën pranë Komisionerit respektivisht më datë 05.06.2014, dhe datë 09.06.2014 dhe masat shtrënguese ndaj z. [emri] nga ana e Albpetrol sh.a, Patos, janë marrë pas kësaj date, dhe kanë ardhur si rezultat i këtyre ankimeve, ligji 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi" ka parashikuar në nenin 3, pika 8 të tij, se: **"trajtimi i disfavorshëm apo pasoja negative, që vjen si reagim ndaj një ankimesi a një proçedimi që synon zbatimin e parimit të barazisë është "Viktimizim".**

Referuar dokumentit: Certifikatë Familjare, nr serie: 007500539, datë 08.01.2015 të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Patos, rezulton se [emri] është i biri i [emri] dhe [emri]. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi me Vendimin nr.202, datë 09.12.2014 ka konstatuar diskriminimin e drejtpërdrejtë të z. [emri] nga ana e Albpetrol sh.a, për shkak dhe të përkatësisë në grupimin sindikal. Po kështu, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi me

⁸ Neni 14, I KEDNJ-së: "Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër."

Vendimin nr. 203, datë 09.12.2014 ka konstatuar diskriminimin e znj. _____ në formën e viktimizimit nga ana e Albpetrol sh.a.

Referuar regjistrin themeltar të punonjësve të Albpetrol sh.a, rezulton se punonjësi ka filluar punë në detyrën "Jurist" pranë Qendrës së Prodhimit të Gazit Patos, në datë 23.08.2007. Me shkresën nr. 3762/1, datë 14.11.2011, _____ është transferuar pranë Qendrës së Prodhimit të Hidrokarbureve Patos në detyrën si specialist i lartë dhe me shkresën nr. 3762/3, datë 18.04.2012 është sistemuar në detyrën si specialist jurist i lartë, pranë QPH Patos. Që nga data 01.05.2013 ka punuar në detyrën Jurist pranë QPNGR Patos derisa i janë zgjidhur marrëdhëniet e punës me Vendimin nr. 516, datë 21.08.2014 për shkak të shkurtimit të vendit të punës dhe ndërprerjen e marrëdhënieve financiare me datë 22.11.2014.

Me shkresën nr. 5070/1, datë 24.09.2008, punëdhënësi Albpetrol sh.a ka lidhur një marrëveshje kualifikimi me punëmarrësin z _____ në të cilën Albpetrol sha angazhohet të financojë punëmarrësin z _____ me qëllim kualifikimin e tij duke ndjekur studimet Master pasuniversitar pa shkëputje nga puna.

Në datë 01.08.2013, mes punëdhënësit Albpetrol sha dhe punëmarrësit z _____ është lidhur një kontratë punë individuale me afat dy vjeçar deri në datë 31.07.2015 në të cilën punëmarrësi ka pasur të përcaktuar pozicionin e punës si Jurist.

Bazuar në strukturën organizative të QPH Patos, nr. 2260/3, datë 12.10.2011 dhe në strukturën organike të QPNGR Patos, nr. 1523/1, datë 03.05.2013 në administratën e kësaj qendre rezulton që të jetë planifikuar një vend pune si specialist i lartë jurist. Referuar shkresës nr. 1408, datë 29.04.2011 të Drejtorit të Përgjithshëm të Albpetrol sha, znj. _____ është emëruar në pozicionin si "Jurist" e cila referuar Librezës së Punës Nr. i regjistrin themeltar 6084/A rezulton se nga data 26.08.2013 znj. _____ ka qenë pushim me leje lindje dhe është kthyer në punë në datë 21.07.2014.

Referuar Urdhrit nr. 4599, datë 27.11.2013 të administratorit të Albpetrol sha, autoriteti i vetëm për kryerjen e procedurës së punësimit dhe shkëputjes së marrëdhënieve të punës me çdo punonjës të shoqërisë është administratori i Albpetrol sha.

Ligji nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", neni 12, pika 1, germa c), parashikon se: "Ndalohe diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: ...c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës".

Në analizë të provave të marra në shqyrtim rezulton se administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a, si autoriteti i vetëm që kryen procedurën e punësimit dhe shkëputjes së marrëdhënieve të punës ka

qenë tendencioz në vendimin për largimin e z. nga vendi i punës, pasi edhe pse ishte në dijeni se shoqëria Albpetrol kishte investuar vlera monetare për kualifikimin akademik si dhe kishte një kontratë pune individuale me afat dy vjeçar deri në datë 31.07.2015 me z. përsëri ndërmoi veprimin për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës. Duke marrë në konsideratë faktin se pas ndërprerjes së marrëdhënieve të punës me z. shoqëria Albpetrol sh.a, ka emëruar në punë dhe dy punonjës të tjerë në pozicionin e juristit, respektivisht z. emëruar në pozicionin e punës si Jurist pranë qendrës Q.A.R. Patos me Vendimin nr. 595, datë 21.10.2014 dhe z. të emëruar në pozicionin e punës Jurist pranë Q.SH.GJ. Patos me Vendimin nr. 41, datë 27.01.2015, përforcon faktin e pretendimit të subjektit ankues që veprimi i largimit nga puna ka qenë për shkak të lidhjes familjare të z.

Fakti i qëndrimit diskriminues ndaj z. përforcohet dhe me veprimin e mos informimit⁹ dhe mos pagesës së pagës për periudhën Shtator-Nëntor 2015 nga ana e punëdhënësit me arsyetimin se punëmarrësi nuk është paraqitur në punë. Referuar Vërtetimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, datë 30.09.2014, vërtetohet se z. a qenë në punë si përfaqësues i shoqërisë Albpetrol sha në çështjen gjyqësore me paditës: K.LI dhe të paditur Albpetrol sha. Prania në punë e z. përforcohet dhe me faktin që në datë 25.09.2014 në mjediset e Albpetrol sh.a është mbajtur proces verbali mbi dorëzimin e dosjes gjyqësore (me palë paditëse K.LI dhe të paditur Albpetrol sha) të dorëzuar juristit

Për sa më sipër, bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar dhe në vlerësim të të dhënave të mësipërme, Komisioneri vlerëson se ndërprerja e marrëdhënieve të punës të punonjësit qenë diskriminuese për shkak të lidhjes familjare, duke e viktimizuar pasi nuk i është ofruar asnjë mundësi për transferimin në një vend tjetër pune në profesionin si jurist, pavarësisht faktit që në periudhën kur po ndërpriteshin marrëdhëniet financiare¹⁰ është kryer marrja në punë e një punonjësi të ri (Y.S) me të njëjtin profesion

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 12/1/c, nenin 21/1, nenin 32, pika 1, germa c), si dhe nenin 33, pikat 5, 7, 10 dhe 11 të Ligjit Nr.10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit të shtetasit për shkak të lidhjes familjare në formën e viktimizimit, nga ana e shoqërisë Albpetrol sh.a.

⁹ Me kërkesën datë 16.10.2014, avokat i në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të a kërkuar nga Albpetrol sh.a arsyet e mos pagesës së pagës së z

¹⁰ Sipas Vendimit nr. 516, datë 21.08.2014, marrëunienet financiare përfundojnë më datë 22.11.2014.

2. Në referim të pikës 1, shoqëria Albpetrol sh.a, si subjekt që ka konsumuar sjelljen diskriminuese, të bëjë rikthimin e z. I në vendin e mëparshëm të punës.
3. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, shoqëria Albpetrol sh.a, detyrohet që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
4. Në referim të nenit 33, pika 11 e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë sipas parashikimeve të bëra në pikën 13 të po këtij neni.
5. Kujtojmë se bazuar në nenin 35 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” çdo person mban përgjegjësi për veprimet ose mosveprimet e tij por kjo nuk e përjashton përgjegjësinë e institucionit.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

